KRONIKË E ZEZË

Arrestohet i dyshuari që shtiu me armë në ajër për ta frikësuar mikun

Foto: Ilustrim

16 janar 2023, 20:32

Shpërndaje në

Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit ka njoftuar se ka arrestuar një të dyshuar për përdorim të armës dhe armëmbajtje pa leje.

Sipas Policisë i dyshuari është arrestuar të hënën, për një rast që dyshohet se ka ndodhur me 6 janar.

Në njoftimin e Policisë së Kosovës thuhet se i arrestuari dyshohet se me qëllim të frikësimit të mikut të tij, kishte shtënë në ajër me armë zjarri.

"Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, Stacioni Policor Gjilan me datën 06.01.2023 kishte pranuar informatë për një rast të dhunës në familje në një fshat të Gjilanit. Në atë rast i dyshuari V.B. (1970) dyshohet se me qëllim frikësimi ndaj viktimës, mikut të tij kishte shtënë në ajër me armë zjarri. Patrulla Policore kishte dalë në vendin e ngjarjes por nuk kishte arritur që të takonte të dyshuarin me ç' rast e kishte vënë në kërkim policor", thuhet në njoftim.

Policia ka bërë të ditur se të hënën, pas një pune mirë të organizuar operative nga ana e hetuesve policorë, është arritur që të takohet i dyshuari. Atij thuhet se i është konfiskuar një pushkë gjuetie si dëshmi për Gjykatën.

"I dyshuar pas arrestimit është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës. Në lidhje me rastin është njoftuar prokurori i cili ka urdhëruar që ndaj të dyshuarit të ngritët kallëzim penal për veprat penale 'Përdorim i armës', 'Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' dhe 'Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm' dhe rasti do të procedohet në Prokurorinë Themelore", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#ARRESTOHET #FRIKESUAR #I DYSHUARI #MIKU #SHTIU ME ARME

Gruaja rrah bashkëshortin në Prishtinë, viktima merr trajtim mjekësor
Malaziasi tenton t'ia japë 5 euro ryshfet policit kosovar, arrestohet
Burri nga Podujeva e raporton nipin për vjedhje
Godet këmbësoren me veturë, arrestohet i dyshuari dhe dërgohet në mbajtje
Tre persona e grabitin një veturë nën kërcënim të armës, aksidentohen me të
Dy të lënduar në aksidentin në Shakovicë
Arrestohet Fero

Taboola Feed



Hong Kong Apartment Prices Might Actually Surprise You
Hong Kong Apartments | Search Ads | Sponsored

Think that US Online MBA Degrees Are Expensive? Think Again! (View…
Online MBA | Search | Sponsored

15 vjet burgim personit që e rrahu për vdekje bashkëshorten në Samadrexhë

Gjykata Themelore në Prizren e ka dënuar të hënën me 15 vjet burgim të akuzuarin I.H., që dyshohet se më 31 maj të 2019-s, e kishte rrahur për vdekje bashkëshorten e tij, viktimën …

Kohanet

The incredible secret to improving circulation in diabetic feet
CareSocks | Sponsored

TË NGJASHME

I gjenden në shtëpi mbi 19 kg marihuanë, arrestohet i dyshuari

Arrestohet 32-vjeçari i dyshuar për vjedhjen e rëndë që ndodhi mbrëmë në Prishtinë

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.